REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Br. 1119/20
Datum. 25-01-2021
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.1119/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE "Trendy Home" Shpk & "Samire Osmani" B.I- Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar për nevojat e Komunës së Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-20-6037-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "KK PRIZREN", më datën: 22.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar për nevojat e Komunës së Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-20-6037-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"KK PRIZREN".

II. **VËRTETOHET**, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar për nevojat e Komunës së Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-20-6037-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"KK PRIZREN".

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt. 21.12.2020 me nr. 1119/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me inventar për nevojat e Komunës së Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-20-6037-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"KK PRIZREN", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 41 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 21.12.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 31.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:
Përgjigje në pretendimet ankimore te OE ankues: Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit në detaje të pretendimit të OE ankues, analizimit të DT, NJK, specifikacionit teknik, përshkrimi i çmimeve vendimeve të AK, kërkesave për sqarime dhe fakteve të kësaj ekspertize mendon që AK nuk ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe 59 të LPP-së.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë lidhur me ofertën e tyre nga AK KK Prizren, tek kushtet e veqanta është kërkuar garancioni për dy vite, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar deklaratë për garancion prej 12 muaj. Por meqenëse AK-KK Prizren nuk e ka vendosur këtë kriter tek kriteret e njoftimit për kontratë dhe kriteret ne Fleten e Te Dhenave të Tenderit FDT lidhur me kërkesat për garancion prej 2 vite. Kjo nuk mund të konstatohet se kualiteti i produketeve nuk është apo është i mirë. Në këtë rast AK ka shpallur fitues një OE i cili ka çmime të peshuara për 50% më të lira në krahasim me ofertën ankimore në përputhje me nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së. Në cilësinë e eksperti i sygjeroj AK – KK Prizren që para nënshkrimit të kontratës me cilindo nga oferatorët të shiqohen kushtet e garancionit, dhe kërkesat për sigurimin e garancionit të ekzekutimit. Ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë mbi pretendimet për shkeljen e pikave 7.1 & 7.2 mbi kërkesën e përshtatshmërisë për OE Samire Osmani B.I , pretendimi se nuk i plotëson kërkesat tek 7.1 & 7.2 Regjistri si operator ekonomi në profesional dhe komercioal dhe apo Regjistrin e ndermarrjeve ne vendin e juaj të themelimit. Nuk qëndon pasi O.E. Samire Osmani B.I. pjesë e konzorciumit Trendy Home SHPK & Samire Osmani B.I. ka dorëzuar Certifikatat sipas pikës 7.1 & 7.2 dhe konzorciumi krijohet për arsye kur një OE nuk mund ti plotësoj kriteret apo kushtet e një projekti dhe antarët së bashku i plotësojnë. Nuk ka qenë kriter në NJK dhe DT që OE duhet të kenë të regjistruar veprimtarine e mobileve, por edhe po të ishte si kriter ky kriter plotësohet nga bartësi i konozrciumit Trendy Home sh.p.k. Ky pretendim është i pa bazuar

Përgjigje në pretendimin ankimor 3: Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë mbi pretendimet për shkeljen, Grupi i OE i shpallur fitues ka dorëzuar katallogun e nënshkruar dhe vulosur origjinal, si dhe në katallog specifikohen dimenzionet, foto dhe përshkrimi i materialit sipas kërkesës në NJK dhe DT. AK – KK Prizren në përputhje me nenin 59.3 dhe nenin 72 ka mundur të kërkoj sqarime shtesë nga OE. Ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 4: Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë, lidhur me pretendimin se grupi i OE i shpallur fitues lider duhet të ketë 60% ekonomike financiare dhe teknike e profesionale, sqaron se Lidhur me Certifikimet ISO OHSAS 18001, ISO 9001 2015, ISO 14001, nuk është kërkesë specifike në NJK, DT që bartësi i konzorciumit duhet të ketë domosdoshmërisht 60% të kërkesave në certifikatave ISO, Certifikimet ISO janë pjesë e dokumentacioneve të cilat lidhen me aspektin profesional, teknik e profesional. Andaj lidhur me këtë pretendim që lideri i konzorciumit nuk i posedon 60% të certifikimeve ISO, mjafton që certifikimet ti ketë lideri apo ndonjë antar i grupit. Lidhur me Certifikimin OHSAS 18001 pas verifikimeve në organizatën www.iso.org sqarohet se standardi ISO OHSAS 18001 nga marsi 2018 zëvendësohet me standardin e ri ISO 45001. Nga marsi 2021 standardi ISO OHSAS 18001 do të migrohet plotësisht në ISO 45001. Ky pretendim është i pa bazuar

Përgjigje në pretendimin ankimor 5: Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë mbi pretendimet për shkeljen, sa i përket kërkesave mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale, është kërkuar që O.E. të ketë referenca të natyrës së njetë në vlerë 300,000.00 Euro. Pretendimi se disa referenca nga lideri i grupit Trendy Home SHPK, ndërsa disa tjera janë dorëzuar në emër të "Gold-Invest" një operator tjeter i cili nuk është pjesë e konzorciumit i paraqitur në këtë tender. Pas analizimit dhe verifikimit për pretendimin sqarohet se Gold Invest shpk dhe Trendy Home shpk janë i njejti biznes, mirëpo biznesi nga themelimi ka operuar me emrin Gold Invest, ndërsa nga data 10.04.2018 ka

vendosur të ndryshoj emrin e biznesit në Trendy Home, me vendime dhe sipas procedurave të cilat rregullohen në ARBK. Referencat dhe kontratat duhet të merre përbazë pasi është i njejti biznes dhe vetëm ka ndryshuar emrin. Ky pretendim **është i pa bazuar**

Eksperti shqyrtues teknik sqaron që AK ka vepruar duke respektuar nenët 1, 6, 7, 59, të LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet dhe të gjeturat në këtë ekspertizë, eksperti shqyrtues teknik i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht të bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK për këtë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti kontraktues me datë 05.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik me datë 06.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Me datën 05.01.2021 përmes emailit nga OSIIP kemi pranuar Raportin e Ekspertit Shqyrtues të Prokurimit nr. I I 19/20 të datës 31.12.2020 i cili ka dhënë përgjigjet në pretendimet ankimore sipas ankesës së dorëzuar në OSIIP me datën 18.12.2020 kundër Autoritetit Kontraktues Komuna e Prizrenit për procedurën e prokurimit me titull: Furnizim **me invetar** për **nevojsit** e Komunës së Prizrenit me nr. Të prokurimit 622-20-6037-1 -1 - 1.

Pas shqyrtimil dhe analizimil të Raportit, erdhëm në një përfundim se Eksperti Shqyrtues raportin nuk e ka bazuar në dispozitat e ligjit te Prokurimit Publik, si dhe nuk i është qasur në mënyrë profesionale dokumentacionit të tenderit. ntik e ka nxjerrë në pah gjendjen faktitke si dhe nuk i ka marrë për bazë shkeljet e bëra nga Autoriteti Kontraktues, e po ashtu ka konstatuar se disa nga pretendimet tona kanë qenë të pa bazuara.

Më poshtë po japim edhe njëherë komentet tona në lidhje me secilën përgjigje të cilën e ka dhënë Eksperti Shqyrtues në lidhje me pretendimet tona ankimore:

I. Në pretendimin ankimor nr. 1 i cili ka të bëjë me kushtet e veçanta në nenin 34.5 është paraparë që Pcriudha garantuese e delëkteve është 2 vite. Pasi kemi ekzaminuar deklaratën për garancion të paraqitur nga O.E. i rekomanduar për kontratë kemi vërejtur se ka ofruar deklaratën për garancion për një afat prej 12 muajve. Nga ajo që u cek më lartë, shihet se Operatori Ekonomik do të përmirësoj defektet vetëm për një periudhë prej 12 Muajve e jo për 2 vite sikur ka kërkuar AK. Në lidhje me këtë pikë, Eksperti Shqyrtues ka konstatuar se meqenëse AK KK Prizren nuk e ka vendosur këtë kriter tek kriteret e njoftimit për kontratë dhe kriteret në FTD lidhur me kërkesat për garancion prej 2 viteve kjo nuk mund të konstatohet se kualiteti i produkteve nuk

është apo është i mirë. Me këtë konstatim Eksperti Shqyrtues është treguar i njëanshëm dhc jo profesional pasi që O.E. i rekomanduar shprehimisht në deklaratë ka cekur se ofron garancion për një periudhë prej 12 muajvc. Në nenin 18 të RRUOP-s në pikën 18.3 shprehimisht është paraparë që Kushtet e veçanta duhet të plotësohen nga Zyrtari i Prokurimit në kohën e përgatitjes së Dosjes se Tenderit. AK ka vepruar sipas kësaj pike dhe në kushtet e veçanta e ka vendosur kërkesën që inventari duhet lë ketë garancion 2 vite. Andaj kërkesa ka qenë e qartë dhe për këtë nuk ka dilema se pretendimi jonë është plotësisht i bazuar.

2. Në përgjigjen në pretendimin nr. 2 Eksperti Shqyrtues ka c'ekur sc "Samire Osmani" B.I. si pjesë c konzorciumit ka dorëzuar certifikatat sipas pikës 7.I&7.2 dhe konzorciumi krijohet për këtë arsye kur një O.E. nuk mund ti plotësoj kriteret apo kushtet e një projekti dhe anëtarët së bashku i plotësojnë. Gjithashtu ka cekur që kjo kërkesë nuk ka qenë kriter në N.IK dhe DT që O.E. duhet të kenë të regjistruar veprimtarinë e mobileve, por edhe po të ishte si kriter, ky kriter plotësohet nga bartësi i konzorciumit. Ky konkluzion është krejtësisht i gabuar dhe i pa bazuar. Është e vërtetë se konzorciumi krijohet kur një O.E. nuk mund ti plotësoj i vetëm kriteret, por anëtarët e grupit duhet të jenë të një lëmije e cila është njejtë mc natyrën e prokurimit dhe këtë e dëshmon vetëm certifikata e biznesit në të cilën janë të listuara aktivitetet e një biznesi. Andaj edhe në këtë pikë Eksperti ka qenë i njëanshëm dhe nuk ka dhënë një konkluzion të bazuar.I.idhur me pretendimin ankimor nr. 3 Eksperti shqyrtues i ka ikur pretendimit tonë dhe të njëjtin nuk e ka përfshirë në përgjigje. Në këtë rast haptas është shprehur i njëanshëm. AK në kërkesë kanë cekur se O.E. duhet te prezantoj tek A.K. për secilin produkt nga një(l) FOTO për produktet e ofruara sipas specifikave teknike te kërkuara nga AK dhe karakteristikave në DT dhe NJK në formë Katallogu -broshure-ORIGJINAL e nënshkruar dhe vulosur nga O.E.dhe tc prezentohet vizatimi teknik i produkteve ku do te prezentohet edhe dimenzionet dhe kualiteti. Ne në pretendim, nuk kemi cekur se grupi i O.E. i rekomanduar nuk e ka dorëzuar katalogun e vulosur dhe të nënshkruar, por ky grup nuk ka dhënë shënimet e kërkuara nga AK për vizatimin teknik të produkteve edhe dimenzionet sikur është kërkuar nga AK për secilin produkl të kërkuar në dosjen e tenderit dhe përshkrimin e çmimeve për 34 produkte dhe atë: B- A23.3; B-A24.I; B-A24.2; B-A24.3; B-A24.4; B-A25.1; B-A25.2; B-A25.3; B-A25.7; B-A26.2;B-A26.3; B-A26.4; B-A26.6? B-A27.3; B-A27.4; B-A27.5; B-A27.6; B-A27.7 B-A27.8; B- A28.I; B-A28.2; B-A28.3; B-A28.4; B-A28.5; B-A28.6; B-A29.2; B-A29.3; B-A29.4; B-A29.5; C-A30; C-A3I; C-A32; C-A30;.dhe C-A33. Sa i përket asaj se AK ka mimdur të kërkoj sqarim në lidhje me katalogun, ky konkluzion është i gabuar pasi që në nenin 72 paragrafi 3 të LPP-s shprehimisht është paraparë që: Citat "Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e flksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Katalogu nuk është dokument ekzistenca e të cilit është e fiksuar. Andaj për një dokument të tillë nuk lejohet

që të kërkohet sqarim. Pra sikur shihet edhe ky pretendim është plotësisht i bazuar.

4. Edhe pretendimi nr. 4 është shqyrtuar pjesërisht. Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar vetëm një pjesë të këtij pretendimi. Eksperti shqyrtues nuk e ka marrë për bazë që grupi nuk i kanë plotësuar certiflkatat OHSAS 18001 për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë dhe ISO 14001 - Sistemet e menaxhimit të mjedisit pasi që këto certifikata i ka ofruar anëtari i grupit "Samire Osmani'' B.l. dhe këto certifikat nuk kanë të bëjnë me inventarin por janë dhënë me qëllim të oliimil të shërbimeve D.D.D. Për krahasim të dokumenteve eksperti ka mundur që ti merr Cerlilikatat tona në të cilat shënon se janë dhënë për inventar. Gjithashtu mund të krahasohen certifikatat ISO 9001 2015 -Sistemi i menaxhimit te cilësisë të dorëzuar nga vet anëtarët e grupit ku certifikata e liderit është për inventar njëjtë sikur certifikata jonë, ndërsa certifikata e anëtarit të grupit është për shërbime D.D.D. Pra eksperti në raport nuk e ka trajtuar këtë qështje por ka dhënë një përgjigje në mënyrë sipërfaqësore me qëllim të shmangies së pretendimit. Edhe ky pretendim i joni është plotësisht i bazuar.

Andaj, ne si ankues ndaj padrejtësis që na është bërë nga ana e Autoritetit Kontraktues, nuk pajtohemi në me mendimin e Ekspertit Shqyrtues si dhe me përgjigjet e dhëna në raportin në tjalë për arësyet e cekura më lartë. Edhe një herë kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të mbajë seancën dhe të shqyrtojë provat të cilat i kemi paraqitur në ankesë duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe njol'limin për kontratë si dhe në dispozitat ligjore të Iegjislacionit të Prokurimit dhe lëndën ta kthej në rivlerësim.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 22.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Sa i përket pretendimit të OE "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë lidhur me ofertën e tyre nga AK, tek kushtet e veçanta është kërkuar garanci për dy vite, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar deklaratë për garanci prej 12 muaj. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional/teknik sqaron se AK nuk e ka vendosur këtë kriter tek kriteret e njoftimit për kontratë dhe kriteret në Fleten e Të Dhënave të Tenderit (FDT) lidhur me kërkesat për garanci prej 2 vite. Kjo nuk mund të konstatohet se kualiteti i produkteve nuk është apo është i mirë. Në këtë rast, AK ka shpallur fitues një OE i cili ka çmime të peshuara për 50% më të lira në krahasim me ofertën ankimore në përputhje me nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së. Andaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional/teknik i sugjeron AK-së që para nënshkrimit të kontratës me cilindo nga operatorët të shikohen kushtet e garancisë dhe kërkesat për sigurimin e garancisë së ekzekutimit. Ky pretendim

është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë mbi pretendimet për shkeljen e pikave 7.1 & 7.2 mbi kërkesën e përshtatshmërisë për OE Samire Osmani B.I, pretendimi se nuk i plotëson kërkesat tek 7.1 & 7.2 Regjistri si operator ekonomi në profesional dhe komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional/teknik sqaron se nuk qëndron pasi OE Samire Osmani B.I. pjesë e konzorciumit Trendy Home SHPK & Samire Osmani B.I. ka dorëzuar Certifikatat sipas pikës 7.1 & 7.2 dhe konzorciumi krijohet për arsye kur një OE nuk mund ti plotësoj kriteret apo kushtet e një projekti dhe anëtarët së bashku i plotësojnë. Nuk ka qenë kriter në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit që OE duhet të kenë të regjistruar veprimtarin e mobileve, por edhe po të ishte si kriter ky kriter plotësohet nga bartësi i konozrciumit Trendy Home sh.p.k. Ky pretendim është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë mbi pretendimet për shkeljen, se grupi i OE i shpallur fitues ka dorëzuar katalogun e nënshkruar dhe vulosur origjinal, si dhe në katalog specifikohen dimensionet, foto dhe përshkrimi i materialit sipas kërkesës në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit. Ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë, lidhur me pretendimin se grupi i OE i shpallur fitues lider duhet të ketë 60% ekonomike financiare dhe teknike e profesionale, sqaron se lidhur me Certifikimet ISO OHSAS 18001, ISO 9001 2015, ISO 14001, nuk është kërkesë specifike në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit që bartësi i konzorciumit duhet të ketë domosdoshmërisht 60% të kërkesave në certifikatave ISO, Certifikimet ISO janë pjesë e dokumentacioneve të cilat lidhen me aspektin profesional, teknik e profesional. Andaj lidhur me këtë pretendim që lideri i konzorciumit nuk i posedon 60% të certifikimeve ISO, mjafton që certifikimet ti ketë lideri apo ndonjë anëtar i grupit. Lidhur me Certifikimin OHSAS 18001 pas verifikimeve në organizatën www.iso.org sqarohet se standardi ISO OHSAS 18001 nga marsi 2018 zëvendësohet me standardin e ri ISO 45001. Nga marsi 2021 standardi ISO OHSAS 18001 do të migrohet plotësisht në ISO 45001. Ky pretendim është i pa bazuar

Lidhur me pretendimin ankimor të OE "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë mbi pretendimet për shkeljen, sa i përket kërkesave mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale, është kërkuar që OE të ketë referenca të natyrës së njëjtë në vlerë 300,000.00 Euro. Pretendimi se disa referenca nga lideri i grupit Trendy Home SHPK, ndërsa disa tjera janë dorëzuar në emër të "Gold-Invest" një operator tjetër i cili nuk është pjesë e konzorciumit i paraqitur në këtë tender. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit sqaron se

pas analizimit dhe verifikimit për pretendimin sqarohet se Gold Invest shpk dhe Trendy Home shpk janë i njëjti biznes, mirëpo biznesi nga themelimi ka operuar me emrin Gold Invest, ndërsa nga data 10.04.2018 ka vendosur të ndryshoj emrin e biznesit në Trendy Home me vendim dhe sipas procedurave të cilat rregullohen në ARBK. Referencat dhe kontratat duhet të merren për bazë pasi është i njëjti biznes dhe vetëm ka ndryshuar emrin.

Paneli shqyrtues sqaron se sipas OE ankues ka patur disa devijime te cilat duhet te merren parasysh nga paneli shqyrtues por te gjitha ato, paneli shqyrtues i konsideron devijime të vogla në harmoni me nenin 59 paragrafi 4 pika (ii) për shkak se këto devijime nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit dhe nuk ndikojnë realisht në realizimin e një kontratë të tillë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, konsideron se autoriteti kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka pasur parasysh qëllimin e ligjit, ku në nenin 1 është përcaktuar që fondet publike duhet të përdoren në mënyrën më ekonomike, si dhe konform nenit 6 të LPP-së me qëllim të arritjes së ekonomicitetit dhe efikasitetit. Ku edhe vet OE ankues e pranon ne ankesën e tije se ka ofruar me çmim gati dyfish me te larte se OE i rekomanduar per kontrate, Po ashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të tenderëve ka vepruar në harmoni me nenin 59 dhe 60 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "KK Prizren";

1x1 OE "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.